



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.71

Njësia e Vendosur në Tender Nr.65

NSH DLB-Parcela 648-0 ZK Vlashnje Prizren

Emri i NSh.-së	NSH "D.L.B Lavërtaria-Blegtoria" - Prizren në likuidim ("Ndërmarrja") (emrat e mëparshëm): PIK "Progres-Export"- "Ratarstvo" sa P.O Dusanovo, "Progres Export- Ratarstvo i Stocarstvo " Fi.-698/89, Fi.-7337/92).
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	Më 16.04.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Çmimi minimal	4,500 €/ari
Depozita e Ofertës	4,000 €
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Rezidenciale

Përshkrimi i Aseteve

Vendndodhja e Aseteve	<p>Zona Kadastrale Vlashnje, Komuna Prizren</p> <p>Të dhënat e hartës ©2024 Google</p> <p>Shikoni këtë pronë në Google Maps</p> <p>Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.</p>
-----------------------	---

Ndërtesat dhe tokat	<p>NSH DLB-Parcela 648-0 ZK Vlashnje Prizren-ofron për shitje tokën bujqësore që ndodhet në Zonën Kadastrale Vlashnje dhe përfshinë ngastrën kadastrale P-71813006-00648-0 me sipërfaqe prej 841 m² (arë kl.1) e regjistruar në emër të NSh-së në Certifikatën për të Drejtat Pronësore të Pasurisë së Paluajtshme.</p> <p>Nga vizita në terren dhe analiza e të dhënave kadastrale që poseduam mund të konstatojmë:</p> <ul style="list-style-type: none">•Parcela shtrihet në brendi të Zonës Kadastrale Vlashnjë, në afërsi të banimit rural.•Parcela përben tërësinë e tokës me sipërfaqe 8ari e 41m² (841m²).•Dallimi i sipërfaqes së parcelës, sipërfaqes grafike dhe tekstuale (teknike dhe juridike) është brenda tolerancës së lejueshme.•Parcela ka qasje në rrugë të pa kategorizuar.•Parcela në teren dukej që kishte kulture bujqësore livadh, por kjo nuk mund të vërtetohet saktë për arsye se parcela ishte e mbuluar me borë.•Parcela shtrihet në zone të kombinuar bujqësore dhe banim rural (shih fotot nga terreni). <p>Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.</p>
---------------------	---



Vërejtje për pronën për ofertuesit e mundshëm:

Në pronën lëndë e shitjes, në Certifikatën e Pronës së paluajtshme nuk ka të regjistruar barrë tatimore.

Në kërkesën e AKP ZR Prizren lidhur me informatën për barrë tatimore (kërkesave të ZR Prizren) ATK është përgjigjur me shkresën e datës 19.01.2017, 24.01.2017, 15.09.2017 dhe 22.11.2018 se NSH-ja ka të vendosur barrë tatimore që nga data 03.12.2013. Në përgjigjen e datës 24.01.2017 nga ZQ ATK Prishtinë, përveç informative për barrë tatimore të vendosur është bashkangjitur edhe Konkluzioni nga ZKK Prizren i dt. 10.02.2014 përmes së cilës kërkohet nga ATK-ja që barra të vendosur tatimore në prona të DLB-se, të pezullohet përkohësisht. Gjithashtu, me dt.02.03.2017 është dërguar kërkesa në ATK-Prishtinë për rishqyrtim të barrës tatimore të vendosur në pronën e NSH-se, dhe me dt. 13.03.2017 është pranuar përgjigja nga ATK-ja ku ceket se vendosja e barrës tatimore është bërë me 03.12.2013 para fillimit të likuidimit të NSH-se në fjalë dhe se nuk është në kundërshtim me Ligjin 03/L-222, Udhezimi administrativ 2010/15 dhe Memorandumit në mes ATK dhe AKP.

AKP ZR Prizren, nuk është njoftuar zyrtarisht nga ana e ATK-së as nga ana e ZKK-se mbi vendosjen respektivisht pezullimin e perkohshëm të barrës tatimore ndaj tërë pronës së NSH DLB Lavertari Blegtori. Me 05.11.2018 është ri-dërguar kërkesa për regjistrim të barrës tatimore dhe me 22.11.2018 është pranuar përgjigja nga ATK-ja se NSH-ja ka të vendosur barrë tatimore që nga data 03.12.2013. Me 02.05.2024 është dërguar kërkesa në ATK nëse NSH-ja ka të regjistruar barrë tatimore, dhe me datë 14.05.2024 është pranuar përgjigja nga ATK se NSH-ja ka të vendosur barrë tatimore

Shfrytëzuesit

Nuk ka.

Asetet tjera


Nuk ka.

Detyrimet që do të barten

Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës



D.L.B Lavërtari Blegtori - Parcela 648-0 në ZK Vlashnje



Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet në shitje

Burimi: <http://geoportal.rks-gov.net/> date 10.01.2025



Raporti i vizitës në teren



15 janar 2025

Raport nga vizita në terren - D.L.B Lavërtari Blegtori - Parcela 648-0 në ZK Vlashnjë

Më datën 14.01.2025, kemi vizituar pronën e DLB Lavërtari Blegtori e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Vlashnjë, Komuna Prizren.

Nga raporti i te dhënave kadastrale (Certifikata nga SIXTK, shërbimet digjitale) prona evidentohet në emër të Pasuri Shoqërore K.B.I PROGRES me numër të njësisë P-71813006-00648-0; sipërfaqe 841m²; kulture bujqësore Arë e klasës 1-rë.



Fig.1 Ortofoto, parcela kadastrale nr. 648-0, ZK Vlashnjë; <http://geoportal.ks.gov.net/>

Nga vizita në terren dhe analiza e te dhënave kadastrale që poseduam mund të konstatojmë:

- Parcela shtrihet në brendi të Zonës Kadastrale Vlashnjë, në afërsi të banimit rural.
- Parcela përbën tërësinë e tokës me sipërfaqe 8ari e 41m² (841m²).
- Dallimi i sipërfaqes së parcelës, sipërfaqes grafike dhe tekstuale (teknike dhe juridike) është brenda tolerancës së lejueshme.
- Parcela ka qasje në rrugë të pa kategorizuar.
- Parcela në terren duket që kishte kulture bujqësore livadhi, por kjo nuk mund të vërtetohet saktë për arsye se parcela ishte e mbuluar me borë.
- Parcela shtrihet në zone të kombinuar bujqësore dhe banim rural (shih fotot nga terreni).

1 / 2

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritës Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Fig. 2 Fotografji nga terreni



Tereza Hajdari

T. Hajdari
Zyrtar Kadastral

Nazmije Polloshka

N. Polloshka
Zyrtar i Zyrës Rajonale

2 / 2

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Llakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**Informatat dhe
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090,2059
www.pak-ks.org
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Dritan Hoxha, nr.55
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës